

Opinione & Komete

Çfarë po bën Kosova për personat me dhunti?



Linda Abazi-Morina

"Fëmijët dhe të rinjtë me dhunti të jashtëzakonshme, të cilët kanë potencial për të treguar nivele tepër të larta të arritjeve në krahasim me bashkëmoshatarët", ky përkufizim i Departamentit të Edukimit të SHBA-së është një prej definicioneve më gjithëpërfshirëse, të cilët definojnë personin me potencial të jashtëzakonshëm intelektual. Ky definicion flet për dhuntinë, performancën dhe arritjen. Kjo edhe konfirmon faktin se nuk është e mjaftueshme që një person të ketë vetëm dhuntinë; ai/ajo duhet ta përdorë atë dhunti për të arritur nivele të larta të zhvillimit intelektual. Në shumë vende të zhvilluara të botës investimi në këta persona është mirë i organizuar, ku shteti ofron përkrahje institucionale, madje disa vende kanë nxjerrë edhe ligje dhe kanë dizajnuar strategji të veçanta në mënyrë që të bëhet identifikimi dhe përkrahja e tyre që në moshat e hershme. Studimet e ndryshme tregojnë se krahas familjes, janë mësimdhënësit ata të cilët e nuhasin ndër të parët dhuntinë dhe kreativitetin të fëmijët. Është genësore që fëmijët të cilët identifikohen të jenë me inteligjencë të jashtëzakonshme shkolla t'ju ofrojë planprograme mësimore sfiduese, të sofistikuar në mënyrë që këta fëmijë ta realizojnë plotësisht potencialin e tyre. Është me rëndësi të kuptohet se personat me dhunti të jashtëzakonshme intelektuale mund të zhvillohen në mënyrë asimetrike, shpesh zhvillimi i tyre intelektual është përparë zhvillimit fizik dhe funksionet e veçanta njohëse dhe socio-emocionale mund të zhvillohen në mënyrë të pabarabartë. Për këtë arsye, për t'i plotësuar nevojat sociale të fëmijës, sidomos në klasat

Sallama, e se Martes janë ne nisurë evokate Institut Demokrataci për Zhvillim (D4D) Saloni ka bërurë Gjyrmatorial sipas rregullës Chaharri Holise dhe pa prapë te medieve. Diskutimi mbledhë rreth vetes eksportë e analistë, publikatë e publicistë për të reflektuar dhe bekuar konsensusi mbi lëvizje e përzgjedhura. Fjalë e hapjes postohet në karabin e Salitave në You Tube. Secu Salion përcillet me editorial që publikohet në "Zeri" të martës e ardhshme dhe në rajon elektronik të D4D së Postastet bazuar të edituar mund të gjeni në uebfaqen tonë Salionit. Madje do të mbledhë sot në 28 mars prej orës 15:45 në "Ditë Nat" me temën: "Sa po e përparë son luavendi shqiptarë Kosovate".

Ekziston stereotipi që këta persona duhet ta dëshmojnë vetë që kanë dhunti. Mëpo jo të gjithë personat e kanë këtë mundësi, pasi që performanca e tyre varet nga faktorë të ndryshëm socio-ekonomikë. Është domosdoshme që këta persona të identifikohen me kohë, pasi që nëse nuk bëhet një gjë e tillë mundësia që ata të mos përmblushin potencialin e tyre intelektual është shumë e madhe. Çështja e promovimit të personave me dhunti nuk duhet të mbetet vetëm brenda familjes apo institucionit ku ata mësojnë, por edhe shoqëria civile e mediet mund të luajnë një rol të madh në promovimin e tyre dhe në vetëdijesimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Në nivel institucional, Kosova është duke bërë shumë pak për këta persona. Vendi ynë nuk ka infrastrukturë ligjore që trajton në mënyrë specifike personat me dhunti. I vetmi instrument që synon t'i dallojë këta persona është një udhëzim administrativ "Për mundësinë dhe procedurat e realizimit të procesit të avancimit të nxënësve", i cili lejon avancimin për nxënësit me talent që të bëhet brenda një shkalle/niveli në një shkallë/nivel tjetër dhe avancimi i tërë nivelit. Sidoqoftë, avancimi në nivele për të pasur ndikim pozitiv tek fëmija duhet të shoqërohet edhe me elemente tjera mbështetëse, si ofrimi i përkrahjes psiko-sociale për fëmijën apo edhe dizajimi i një plani individual që i përshtatet shkathtësive dhe nivelit të zhvillimit intelektual të fëmijës. Për më shumë, mësimdhënësit duhet të marrin udhëzime të detajuara, qoftë edhe përmes trajnimeve në identifikimin dhe menaxhimin e fëmijëve me dhunti.

fillore, shpesh rekomandohet që fëmija të qëndrojë me moshatarët nëse shkolla nuk ka kapacitete që të ofrojë përkrahje psiko-sociale krahas asaj akademike.

Në Kosovë i është kushtuar shumë pak vëmendje apo është lënë krejtësisht anash një grup i fëmijëve dhe të rinjve me dhunti intelektuale të jashtëzakonshme. Duhet të jemi të vetëdijshëm si shoqëri se identifikimi dhe përkrahja e këtyre personave jo vetëm që ndihmon ata/ato direkt në plotësim të potencialit të tyre intelektual, por është shumë me rëndësi të dihet se këta persona janë një potencial i jashtëzakonshëm i zhvillimit të një shoqërie. Është shumë me rëndësi që personat me dhunti intelektuale të identifikohen herët. Mosidentifikimi i hershëm i këtyre personave mund të ndikojë negativisht që aftësitë e tyre të mos shprehën për shkak të mundësive të kufizuara të tilla si: varfëria, diskriminimi, barrierat kulturore apo për shkak të problemeve emocionale dhe të motivacionit.

Deri më tani në Kosovë që nga viti 2011 është vetëm organizata "Encompass", me projektin "Atom", i cili synon identifikimin e fëmijëve me inteligjencë të jashtëzakonshme. Sidoqoftë, për të pasur një qëndrueshmëri dhe përcjellje të vazhdueshme të zhvillimit të kësaj kategorie të personave është kritike që institucionet arsimore të bëjnë më shumë për adresimin e kësaj çështjeje, qoftë përmes përpilimit të programeve të veçanta për zhvillimin akademik të këtyre personave në mënyrë që shkollat të kenë planprograme specifike për identifikimin e hershëm të tyre, apo edhe të ofrojnë mësim të diferencuar për këta fëmijë. Përderisa nuk ofrohet strategji për përkrahjen institucionale të personave me dhunti intelektuale, këta persona mund të mbeten krejtësisht të zakonshëm në hapësirat ku ata jetojnë. Kjo do të ishte jo vetëm humbje personale e një potenciali të jashtëzakonshëm intelektual, por do të ishte edhe humbje e madhe edhe për shoqërinë.

SYRI

FOTO: DRITON BUBLAKU



 www.zeri.info/zeral/